

VENDIM
Nr. 215, datë 15.10.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E
LICENCËS ME NR. 129, SERIA PV11K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SELISHTË” SHPK, ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 60, DATË 22.6.2011**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; nenit 7, 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133/3 prot., datë 13.10.2021, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.9.2021, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Selishte” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020 për licencën në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 949 prot., datë 15.9.2021, shoqëria është njoftuar për vendimarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Bazuar në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s (*statement*), rezulton se kjo debi është shlyer në datën 11.10.2021. Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në referim të nenit 42, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatitin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t’i propozojnë Bordit:

- a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.”.

- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet, se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “Selishte” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Selishte” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Selishte” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti